

Tiranë më 09.11.2014

**Drejtuar: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ)**

**Lënda: Shprehje falenderimi**

E nderuar Znj. Luzi,

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), duke marrë shkas nga përgatitja dhe dërgimi i paketës së rekomandimeve në Parlamentin Shqiptar nga ana e KQZ-së, gjen rastin të falenderojë Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, Drejtorinë Juridike me përfaqësuese Znj. Pasko, Sekretarin e Përgjithshëm, Z. Vrioni dhe Juve personalisht, për realizimin e tryezave teknike, takimeve dhe përfshirjen e sugjerimeve e ideve të shprehura nga ana e FSHDPAK-së.

Vlerësojmë shumë gatishmërinë tuaj, përfshirjen dhe bashkëpunimin efektiv gjatë procesit, që po udhëheq ndryshimet e domosdoshme ligjore për përmirësimin e situatës zgjedhore për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Shpresojmë dhe besojmë, që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe përgjatë fazave të ardhshme të diskutimeve dhe të rezultojë në përmirësime konkrete të Kodit Zgjedhor.

Duke Ju falenderuar,

Ne respekt,

Blerta CANI

Drejtor Ekzekutiv

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

